



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME**

Rruga "Jordan Misja", Pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda

Tel. +355 4 2232 852

Nr. 365 Prot.
(lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 06.10.2009

Lënda: Dërgohet Raporti për aktivitetin e Shërbimit të Provës.

Drejtuar: **Z. BUJAR NISHANI
MINISTËR I DREJTËSISË**

Për dije: **Z. SALI BERISHA
KRYEMINISTËR**

TIRANË

I nderuar Z. Ministër!

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative"", po ju paraqes raportin e aktivitetit të Shërbimit të Provës për periudhën 1 qershor – 30 shtator 2009.

Bashkëlidhur ju përcjellim Raportin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARBEN SEFGJINI

Konc. Saimir Shyti
Date 06.10.2009



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
SHËRBIMI I PROVËS

R A P O R T I
PËR PERIUDHËN 1 QERSHOR - 30 SHTATOR 2009

05 Tetor 2009

RAPORT MBI AKTIVITETIN KATËR MUJOR TË SHËRBIMIT TË PROVËS

I nderuar Zoti Ministër,

Mbështetur në nenin 9, gërma gj), të VKM nr. 302, datë 25.03.2009 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative””, po ju paraqes raportin e aktivitetit të Shërbimit të Provës për periudhën 1 qershor – 30 shtator 2009.

Histori e Shkurtër

Shërbimi i Provës është organ shtetëror në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i krijuar në bazë të Ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar me ligjin Nr.10 024, datë 27.11.2008.

Gjithashtu, Institucioni i Shërbimit të Provës funksionon në bazë të *Rregullores* “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve dhe procedurave për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative” të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 25.03.2009, *Urdhërit të Kryeministrit* Nr. 67, date 06.05.2009 “Per miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës”, *Urdhërit* nr. 5331/1, datë 06/07/2009 të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e vendndodhjes dhe kompetencave tokësore të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës”, si dhe akteve të tjera nënligjore.

Shërbimi i Provës përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, si dhe zyrat vendore, të cilat janë të organizuara pranë gjykatave të rretheve gjyqësore. Aktualisht Shërbimi i Provës ka vetëm 4 Zyra Vendore me vendodhje në qytetet Shkodër, Tiranë, Durrës dhe Fier të cilat i shtrijnë kompetencat tokësore të tyre në rrethet gjyqësore të përcaktuara në Urdhërin e Ministrit të Drejtësisë Nr. 5331/1, datë 06/07/2009, duke mbuluar të gjithë territorin e

vendit.

Misioni i Shërbimit të Provës

Shërbimi i Provës është institucion që duhet të punojë ngushtë me Gjykatën, Prokurorinë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, me Policinë e Shtetit, me Organet e Pushtetit Vendor, me komunitetin, me organizatat e ndryshme jofitimprurëse etj.

Misioni i Shërbimit të Provës në Shqipëri është të mbikëqyrë dhe mbështesë zbatimin e dënimeve alternative me qëllim mbrojtjen e interesave publike, parandalimin e kryerjes së veprave penale, asistimin e personit të dënuar për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dënimi alternativ, asistimin e personit të dënuar për kapërcimin e vështirësive për riintegrimin e tij shoqëror dhe të sjelle ndryshime pozitive në sjelljen e të dënuarve.

Veprimtaria e Shërbimit të Provës për këtë periudhë

Fillimi i punës së këtij institucioni paraqiste vështirësi e pengesa për shumë arsye, por mbi të gjitha për shkak se krijohet për herë të parë në vendin tonë dhe nuk ekzistonte një praktikë në këtë fushë qoftë edhe e dobët apo negative.

Në fillim të punës pyetjet para nesh ishin të shumta, por ndoshta edhe më themeloret si për shembull çfarë është Shërbimi i Provës, cili është roli dhe detyra e këtij organi në sistemin e drejtësisë penale, cili është roli dhe misioni i Shërbimit të Provës në Shqipëri, çfarë do të bëjë punonjësi i Shërbimit të Provës, cilat janë metodat e punës që përdor Shërbimi i Provës për realizimin e detyrave të tij funksionale, cili është raporti i tij me Gjykatën, Prokurorinë apo me faktorët e tjerë të drejtësisë penale etj.

Hartimi dhe Miratimi i Akteve Nënligjore

Një nga detyrat e para që duheshin zgjidhur ishte përgatitja dhe nxjerrja e akteve nënligjore të domosdoshme për fillimin e funksionimit të institucionit. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës në kuadër të detyrimeve ligjore që

përcaktohen ne VKM-në nr. 302, datë 25.03.2009, ka hartuar draft-aktet e mëposhtëme, të cilat më pas janë miratuar nga Ministri i Drejtësisë :

1. Regjistrat e Shërbimit të Provës:

- a) regjistri themeltar i personave të dënuar;
- b) regjistri i kërkesëankesave;
- c) regjistri i shkeljeve të planit individual të trajtimit;
- ç) regjistri i ngjarjeve të rënda;
- d) regjistri i OJF-ve dhe institucioneve të tjera që ofrojnë këshillim dhe asistencë ose vende pune për të dënuarit me dënim alternativ.

2. Modelet e standardizuara të Raporteve të vlerësimit (për të dënuarin/të pandehurin/personin nën hetim), si dhe te Raportit përfundimtar të periudhës së mbikëqyrjes.

3. Modeli i dokumentit identifikues për punonjës in e Shërbimit të Provës

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës ka miratuar në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore:

1. Modelin e standardizuar të Programit individual të trajtimit të të dënuarve;
2. Projekt marrëveshjen e bashkëpunimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve;
3. Modelet e standardizuara të formularëve statistikorë për zyrat vendore me të dhëna mbi të dënuarit (e mitur dhe të rritur);
4. Urdhëra dhe udhëzime të ndryshme për efekt të mirëfunksionimit dhe organizimit të zyrave vendore.

Të gjitha këto akte janë tashmë në dispozicion të cdo punonjësi të Shërbimit të Provës dhe në zbatim prej tyre.

Në bazë te pikës 1, neni 5, te VKM-se nr. 302, datë 25.03.2009, parashikohet se zyrat vendore duhet të jenë të organizuara pranë gjykatave të rretheve gjyqësore,

ndërkohë që aktualisht, ushtrojnë aktivitetin e tyre vetem 4 zyra vendore të Shërbimit të Provës, për shkak se ky është numri i zyrave të përcaktuara në Urdhërit të Kryeministrit Nr. 67, date 06.05.2009 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Provës".

Me qëllim që Shërbimi Provës të shtrinte funksionimin e tij në të gjithë territorin e vendit, megjithëse kemi vetem katër zyra të miratuara, me urdhërin Nr.5331/1, date 06.07.2009 të Ministrit të Drejtësisë u përcaktuan kompetencat tokësore të zyrave vendore të Shërbimit të Provës. Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës i shtrijnë kompetencat e tyre tokësore në vendin ku i dënuari vuan dënimin dhe në vendin ku i dënuari i vënë në provë ka banimin.

Sipas këtij urdhëri:

1. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendodhje në qytetin e Tiranës dhe ka kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Tiranë, Dibër, Kavajë, Krujë, Kurbin.
2. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Durrës ka vendodhje në qytetin e Durrësit dhe ka kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Durrës, Elbasan, Korçë, Pogradec.
3. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendodhje në qytetin e Shkodrës dhe ka kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Shkodër, Lezhë, Kukës, Mat, Pukë, Tropojë.
4. Zyra Vendore e Shërbimit të Provës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka vendodhje në qytetin e Fierit dhe ka kompetencë tokësore në rrethet gjyqësore Fier, Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Lushnjë, Përmet, Sarandë.

Statistika

Për periudhën qershor-gusht 2009, Shërbimi i Provës ka përballuar një fluks të madh pune, i cili është në rritje të vazhdueshme. Tashmë plotësohen rregullisht nga specialistët dosjet personale të të dënuarëve, regjistrat përkatës që na ngarkon ligji e të përmendura më lart në këtë raport, hartohen programet individuale të trajtimit, marrin pjesë në të gjitha seancat gjyqësore, realizohen të

gjitha intervistat e nevojshme me të dënuarit në I EVP dhe të afërmit e tyre për hartimin e raporteve të vlerësimit, përgatiten të gjithë raportet e vlerësimit për Gjykatën dhe raportet e njoftimit për Prokurorinë, etj.

Duke marrë parasysh faktin që Shërbimi i Provës është një institucion i ri, i sapokrijuar dhe me një eksperiencë minimale në fushën që operon, mendojmë që veprimtaria e deritanishme e tij ka qenë në nivele të mira, ka përkushtim, ka ndjekje të të gjitha punëve, kryhen pothuajse të gjitha proceset për të cilat jemi të ngarkuar nga ligji, përgatitet i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga ligji për cdo të dënuar, si dhe po rritet cdo ditë cilësia e punës dhe niveli profesional i punonjësve.

1. Për periudhën 4 mujore pranë zyrave vendore të Shërbimit të Provës, kanë ardhur 280 kërkesa për raporte vlerësimi nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore.
2. Po për këtë periudhë pranë zyrave vendore të Shërbimit të Provës, kanë ardhur 7 kërkesa për raporte vlerësimi nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore.
3. Në adresë të Zyrave Vendore të Shërbimit të Provës kanë ardhur 285 urdhëra ekzekutimi nga prokuroritë e rretheve gjyqësore. Nga këto 47 urdhëra ekzekutimi për të mitur.
4. Kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për 355 persona për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative.
5. Kanë filluar procedurat ligjore të përcaktuara për procesin e mbikëqyrjes për 47 persona të mitur për të cilët gjykata ka dhënë dënime alternative.

Marrëdhëniet me partnerët dhe organizmat ndërkombëtare

Marrëdhëniet tona me OSBE, EURALIUS, UNICEF janë shumë të mira. Kontributi i tyre për ngritjen dhe vënien e themeleve të institucionit tonë në këtë periudhë ka qenë i pazëvendësueshëm. Ata kanë dhënë një ndihmë të jashtëzakonshme për trajnimin e stafit me ekspertë të huaj, na kanë ndihmuar në krijimin e koncepteve dhe parimeve të menaxhimit të një institucioni të tillë, kanë ndihmuar në paisjen me bazë materiale shumë të rëndësishme për ne në këtë fazë kur nuk kishim as kompjutera, as paisje zyre etj etj.

Konkretisht OSBE printoi dhe shpërndau për stafin që në ditët e para librin e pazëvendësueshëm për periudhën që kalojmë me titull “Manual për Punonjës të Shërbimit të Provës”, material i vetëm ky që shërben për orientimin teorik të punonjësve tanë.

OSBE dhe EURALIUS, me kërkesën tonë, organizuan një trajnim të shpejtë 4 ditor me stafin në muajin e parë të fillimit të punës së institucionit, ku u certifikuan 20 punonjës të parë.

Po kështu me datë 22 Shator-28 Shtator 2009 u zhvillua trajnimi i gjithë stafit në një seminar me program të plotë, një trajnim ky i organizuar nga OSBE dhe EURALIUS, dhe ku ishin të ftuar dy lektorët austriake, Jurgen Kaiser dhe Thomas Ohman, me eksperiencë të gjatë në fushën e Shërbimit të Provës.

Një bashkëpunim i frytshëm për këtë periudhë 4 mujore ka qenë ai me UNICEF i cili na ka asistuar me përvojën e stafit të tij në këtë fushë si e vetmja eksperiencë në Shqipëri deri tani. Kjo organizatë ka dhënë një kontribut shumë të vlefshëm për ne edhe me ndihmën që na ofroi në ditët e para e ne vazhdim për paisje zyrash, ndihmë kjo e një rëndësie të vecantë në këtë periudhë të Shërbimit të Provës.

Kemi patur dhe jemi në kontakte edhe me organizata të tjera ndërkombëtare të cilat janë të gatëshme që të ofrojnë ndihmën e tyre në ndërtimin e këtij institucioni.

Marrëdhëniet me institucionet e tjera

Për realizimin e qëllimit është e nevojshme që Shërbimi i Provës të vendosë marrëdhënie bashkëpunimi me institucione të ndryshme. Kështu si pjesë e sistemit të drejtësisë penale Shërbimi i Provës nuk mund të realizojë funksionet e tij jashtë një bashkëpunimi të ndërsjellë me Gjykatën, me Prokurorinë, me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, me Policinë e Shtetit, me Pushtetin Lokal etj etj. Për këtë arsye ne kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me to e vecanërisht në këtë periudhë me Gjykatën dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për shkak se me këto institucione ne kemi edhe fluksin më të madh të punës.

Specialistët e Shërbimit të Provës bëjnë vizita në I EVP për të realizuar intervistat me të dënuarit që i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për të zëvendësuar dënimin me burgim të mbetur pa vuajtur me ndonjë nga dënimet alternative. Në këto kushte kemi kryer punën tonë pa asnjë pengesë, por megjithatë kemi përgatitur edhe memorandumin e bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve i cili është nënshkruar nga drejtuesit e të dy institucioneve. Ndërkohë jemi duke përgatitur draft-marrëveshjen e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit si një hap tjetër i rëndësishëm për punën tonë.

Cështje të administrimit.

I nderuar zoti Ministër!

Është rasti t'ju njoh me problemet që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe administrimin e Shërbimit të Provës dhe për të cilat duhet punuar me shpejtësi nga ana jonë, por që kërkojnë njëkohësisht mbështetjen tuaj të pazëvendësueshme.

1.Problemi i zyrave.

Aktualisht Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës nuk kanë ambiente (zyra) nën administrimin, por disponojne disa zyra të marra me mirëkuptim nga institucionet e tjera, por jashtë cdo parametri për të zhvilluar një aktivitet normal.

Konkretisht:

-Zyra Vendore e Shkodrës dhe e Durrësit zhvillon aktivitetin në një zyrë të marrë me mirëkuptim dhe përkohësisht nga Prefektura e Shkodrës dhe e Durrësit respektivisht.

-Zyra Vendore Fier ka një ambient ku zhvillon aktivitetin të marrë me mirëkuptim dhe përkohësisht nga Këshilli i Qarkut Fier.

-Zyra Vendore Tiranë zhvillon aktivitetin në një zyrë të vetme në mesin në mesin ku ndodhet edhe Drejtoria e Përgjithëshme.

-Drejtoria e Përgjithëshme e Shërbimit të Provës zhvillon aktivitetin në një mesin në mesin në kushte skandaloze dhe jashtë cdo standardi, por që aktualisht jemi duke zhvilluar procedurat e një tenderi për rikonstruksionin e disa zyrave të cilat shpresojmë të lehtësojë në njëfarë mënyre situatën. Aktualisht kemi vetëm 3 zyra në të cilat punojnë të gjithë punonjësit e Drejtorisë së Përgjithëshme dhe ata të Zyrës Vendore Tiranë.

2. Problemi i hapjes së zyrave të reja vendore si strukturë.

Shërbimi i Provës duhet të ketë zyrat e tij vendore pranë cdo Gjykate të Rrethit gjyqësor, sikurse thuhet shprehimisht në VKM nr.302, date 25.03.2009, Kreu III "Organizimi i Shërbimit të Provës", Neni 7/1/b "Shërbimi i Provës është organ i centralizuar, i cili organizohet dhe funksionon në nivel qendror dhe vendor. Ai përbëhet nga...b)zyrat vendore pranë gjykatave të shkallës së parë", që do të thotë duhet të ketë 21 zyra vendore. Aktualisht janë të miratuara në strukturë dhe funksionojnë vetëm 4 zyra vendore të cilat përballojnë ngarkesën për gjithë territorin e vendit. Në këto kushte është shumë e nevojshme hapja e zyrave të tjera ose të paktën hapja e katër zyrave të tjera vendore për të cilat do t'ju dërgoj edhe studimin tonë me argumentat përkatës.

3. Problemi i shtesave të domosdoshme në organikë

Kjo është një çështje e ndjeshme që në fillim të funksionimit të institucionit. Në organikë ne nuk kemi punonjës sanitar gjë që na ka sjellë problem të një natyre të vecantë në lidhje me çështjet e higjienës. Është e domosdoshme të kemi punonjës të tillë ose një mënyrë zgjidhje për këtë çështje si për zyrat e Drejtorisë së Përgjithëshme ashtu edhe për zyrat vendore.

Nga ana tjetër gjithë institucioni i Shërbimit të Provës ka në organikë vetëm një financiar, por në këndvështrimin e ligjeve dhe parimeve të financës duhet të kishim patjetër të paktën edhe një arkëtar dhe një magazinier për institucionin.

Aktualisht të tre këto funksione të papajtueshme me njëra tjetrën kryhen nga i njëjti person që është financieri, i vetmi i përcaktuar në strukturën e institucionit.

Një moment tjetër është edhe problemi që lidhet me organikën e shoferave. Gjithë institucioni ka në organike vetëm një shofer, ndërkohe që ka fonde të përcaktuara në buxhet për blerjet e makinave aq të domosdoshme për lëvizjet e stafit për takimet e intervistat në burgje, në fshatra etj etj. Në këto kushte ne do të paraqesim propozimin tonë me argumentat përkatëse.

4. Problemi i pagave.

Pagat e punonjësve të institucionit janë në nivele që nuk i përgjigjen kushteve dhe vështirësive të punës që kanë punonjësit e Shërbimit të Provës. Ligji kërkon nga punonjësi i këtij institucioni ekspertizë për çështjet me të cilat është ngarkur, vështirësitë e punës janë të mëdha pasi kanë të bëjnë me kontakte dhe komunikime me të dënuarit, të pandehurit, personat nën hetim dhe familjarët e lidhjet e tyre, me vizita në burgje dhe në banesat e familjarëve të tyre në qytet apo zona të thella të vendit, ka të bëjë me mbikëqyrjen e tyre gjatë kohës së provës etj. Ne do t'ju paraqesim propozimin tonë të detajuar për këtë çështje.

Së fundi është e rëndësishme të ritheksojmë se tashmë Shërbimi i Provës trajton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me detyrën e tij funksionale ndërsa po trajtohet në vazhdimësi stafi nga ekspertë të huaj të OSBE, EURALIUS etj dhe po bëhen përpjekje të mëdha që trajnimi të jetë një process i vazhdueshëm për punonjësit tanë jo vetëm tani që kjo është një domosdoshmëri, por edhe në vazhdim.

Duke shpresuar se kemi dhënë një analizë të qartë të problemeve, kërkesave dhe nevojave të institucionit të Shërbimit të Provës ju sigurojmë se zbatimi i të gjithave detyrave funksionale, rritja e nivelit dhe e profesionalizmit do të jenë prioritete të punës sonë.

Me respekt,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARBEN SEFGJINI

